



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

10.02.2022, Prishtinë

## VENDIM

Pas vlerësimit të situatës së krijuar gjatë ndeshjeve të datës 09.02.2022, dhe konsultimit me autoritetet kompetente, Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK) ka marr vendim që ndeshjet gjysmëfinale dhe ato finale të Final 8 Kupës së Kosovës që është duke u organizuar në Pejë të mos lejohet pjesëmarrja e tifozerve të organizuara. FBK ka qenë e detyruar ta marr këtë vendim pasi në ndeshjet e para çerekfinale tifozët e organizuar nuk i kanë respektuar masat në fuqi të Qeverisë së Republikës së Kosovës për anti-Covid19, e që janë mbajtja e maskës dhe distanca fizike edhe pas tërheqjes së vërejtjes nga personat përgjegjës të angazhuar për siguri dhe Policisë së Kosovës.

Duke qenë se grupet e tifozëve të pranishme në palestrën "Karagaçi" nuk iu bindën urdhrave për bartje të maskës dhe sigurim të distancës fizike, duke pamundësuar kështu respektimin e masave nga organizatori dhe Federata, në palestër prej ndeshjeve gjysmëfinale e deri te ato finalet në të dyja konkurrencat do të lejohen vetëm shikuesit e vaksinuar që nuk vijnë në mënyrë të organizuar dhe që zotohen të respektojnë masat në fuqi për anti-Covid19.

Federata e Basketbollit të Kosovës, organizatori i Final 8 Kupës së Kosovës, KB Peja dhe organet e rendit do të bëjnë më të mirën për organizim të mirëfilltë të këtij event, andaj shikuesit të cilët nuk i respektojnë masat në fuqi anti-Covid19 (bartja e maskës dhe distanca fizike) pas vërejtjes së parë do të largohen nga palestra.

Federata e Basketbollit të Kosovës dhe KB Peja ftojnë të gjithë dashamirët e basketbollit që të shijojnë spektaklin e basketbollit në Pejë duke iu përmbajtur rregullave dhe masave të sigurisë, duke dhënë kështu shembull të mirë dhe krijuar precedent pozitiv për kërkesat tona për hapje të mëtejme të palestrave për tifozë.

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij.

Me respekt,

Faton Kurshumlija  
Komesar i Garave



Federata e Basketbollit të Kosovës

### Federata e Basketbollit të Kosovës

+383 48 703 333  
federata@basketbolli.com

Lagja "Arbëria", Blloku  
C3 (Faza 2), Rr. Radovan  
Zogoviq, Hyrja 7  
10000 Prishtinë, Kosovë



REPUBLIKA E KOSOVËS  
MINISTRIA E ARSIMIT, REJDESË  
DHE SPORTIT



REPUBLIKA E KOSOVËS



RUGOVË